



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

BURSA PËR STUDIME UNIVERSITARE NË SLLOVAKI

VITI AKADEMIK 2015-2016

Në bazë të marrëveshjes dypalëshe të bashkëpunimit në fushën e arsimit, Qeveria e Republikës së Sllovakisë ofron bursa studimi universitare në nivelin bachelor/master për shtetas shqiptarë, të cilët dëshirojnë të studiojnë në institucionet shtetërore të arsimit të lartë të Republikës së Sllovakisë për vitin akademik 2015-2016 sipas programeve të studimit në vijim:

1. Pedagogji, kujdestari, shkenca pedagogjike;
2. Shkenca sociale dhe të sjelljes;
3. Ekonomi dhe menaxhim;
4. Ekologji dhe shkenca mjedisore;
5. Arkitekturë dhe inxhinieri;
6. Inxhinieri ndërtimi, teknologji, manifakturë dhe komunikim;
7. Agrikulturë;
8. Pylltari;
9. Menaxhimi i ujit.

Kandidatët e interesuar për këto bursa studimi duhet të dërgojnë **me postë** deri më datë **20.04.2015** në Drejtorinë e Integrimit dhe Projekteve në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, dokumentet e mëposhtme:

1. Kërkesën për studime, duke specifikuar degën në të cilën kandidati dëshiron të studiojë. Në kërkesë të jepet një adresë kontakti e-maili dhe numër telefoni;
2. Vërtetimin e notave për dy vitet e para dhe të semestrit të parë të vitit të tretë të shkollës së mesme. Ky vërtetim duhet të jetë i firmosur nga Drejtoria Rajonale/Zyra Arsimore e rrethit përkatës dhe nga Ministria e Arsimit dhe Sportit;
3. Fotokopjen e kartës së identitetit;
4. Fotokopjen e pasaportës;
5. Raportin mjekësor për aftësi studimi;
6. 4 (Katër) fotografi dokumenti

Kushtet për përfitimin e bursës, përshkrimin e detajuar të degëve studimore, si dhe informacione të tjera gjenden në faqen e internetit të Ministrisë së Arsimit të Republikës së Sllovakisë: www.minedu.sk (Scholarships of the Government of the Slovak Republic).

DREJTORIA E INTEGRIMIT DHE PROJEKTEVE